



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 417/6 Prot.

Tiranë, më 05.06.2019

V E N D I M

Nr. 74, datë 05.06.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë, në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit **”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit *****,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 417 prot., datë 16.04.2019, nëpunësi ***** me detyrë “Specialist në sektorin e çështjeve juridike” në Drejtorinë Juridike dhe Licensave, në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), ka parashtruar pretendimet e tij për mungesë të shkaqeve të ligjshme dhe zbatim të gabuar të parimeve të ligjit material, në zhvillimin e një ecurie disiplinore në ngarkim të tij, në përfundim të të cilës Komisioni i Disiplinës me vendimin e tij nr. 15 dt. 08.04.2019 (nr. 1488/1 prot. dt. 08.04.2019) ka marrë masën disiplinore “Largim nga shërbimi civil”.

Nga tërësia e pretendimeve të ngritura dhe e dokumentacionit të administruar, konstatohet se punonjësi ***** është nëpunës civil i konfirmuar në pozicionin “Specialist në sektorin e çështjeve juridike” në Drejtorinë Juridike dhe Licensave, në Autoritetin e Mediave Audiovizive, prandaj verifikimi i pretendimeve të ngritura për mosrespektim të të drejtave të nëpunësit civil në zhvillimin e ecurisë disiplinore, përfshihet në juridiksionin dhe kompetencën e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Pas marrjes së informacionit në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesën e paraqitur nga nëpunësi ***** , është kryer verifikimi i këtij rasti duke kërkuar nga institucioni i Autoritetit të Mediave Audiovizive, nëpërmjet shkresës menr. 417/1 prot., datë 18.4.2019, *“Kërkim dokumentacioni për verifikimin paraprak të rastit të nëpunësit ***** , në lidhje me vendimin nr. 15, dt. 8.4.2019, të Komisionit Disiplinor, për marrjen e masës disiplinore “Largim ngashërbimi civil”*, gjithëmaterialin shkresor që pasqyron veprimet administrative të kryera nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga organi disiplinor.

Në përgjigje, Sekretari i Përgjithshëm i AMA, me shkresat nr. 1723/1 prot., datë 26.4.2019 dhe nr. 1723/2 prot., datë 7.5.2019, ka dërguar dokumentacionin që pasqyron realizimin e procedurave administrative për marrjen e masës disiplinore ndaj nëpunësit ***** , si dhe aktin me anë të të cilit, organi disiplinor ka vendosur ndërprerjen e ecurisë disiplinore për nëpunësin ***** (vendim nr.14, dt. 8.4.2019 i KD).

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative që janë kryer gjatë këtij procedimi disiplinor, nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore (debat me zë të lartë në ambientet e AMA-s në datën 25.3.2016, ndërmjet ankuesit ***** dhe Drejtorit të Mbikëqyrjes ***** , lidhur me hartimin e procesverbaleve dhe raportit përmbledhës të një procedure prokurimi, i cili ka degraduar në konflikt fizik), e deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga organi disiplinor (vendimi nr. 15, datë 8.4.2019), i Komisionit Disiplinor, për marrje mase disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*), rezultoi e provuar si më poshtë:

Shkelja disiplinore e pretenduar, është konstatuar nga drejtuesi i Njësisë së Burimeve Njerëzore, i cili me shkresën nr. 1305 prot., datë 25.03.2019, *“Konstatim i shkeljes së rregullave të brendshme në institucion”*, ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të AMA, në cilësinë e prorit direkt të nëpunësit ***** dhe Drejtorin e Drejtorisë Juridike dhe Licensave, në cilësinë e prorit direkt të nëpunësit ***** , se në datën 25 mars 2019, rreth orës 15:30, në ambientet e Autoritetit të Mediave Audiovizive, janë parë duke debatuar me zë të lartë punonjësit ***** dhe ***** , debat i cili ka degraduar në konfrontim fizik (zënie me duar) me njëri tjetrin.

Me vënien në dijeni mbi pretendimin për shkeljen disiplinore, eprori direkt i nëpunësit ***** , Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Licensave, bazuar në pikën 1, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, ka filluar ecurinë disiplinore duke e klasifikuar shkeljen disiplinore si *“shkelje të rëndë”*, e për këtë arsye me shkresën nr. 1305/1 prot., datë 25.03.2019, drejtuar Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Sekretarit të Përgjithshëm, ia ka përcjellë rastin për shqyrtim Komisionit të Disiplinës.

Mbi këtë bazë, me urdhrin nr. 89, datë 26.03.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të AMA *“Për ngritjen e komisionit disiplinor për nisjen e ecurisë së procedimit*

disiplinor”, është ngritur Komisioni i Disiplinës, për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore (tëklasifikuara “shkelje e rëndë”) të kryera nga nëpunësit ***** dhe ***** , veprim ky i kryer në përputhje me pikën 2, të kreut I, “Organet disiplinore”, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, të ndryshuar.

Komisioni Disiplinor me shkresën nr. 1314 prot., datë 26.03.2019 “Njoftim mbi fillimin e procedimit disiplinor për shkelje të rëndë”, drejtuar dy nëpunësve të sipërpërmendur, menjëherëka filluar ecurinë disiplinore duke bërë njoftimin e tyre për shkeljen disiplinore të pretenduar si dhe datën 01.04.2019 (por, nëdy orë të ndryshme), si dita në të cilën do të zhvillohej seanca për shqyrtimin e saj.

Me shkresën nr. 1312/1 prot., datë 26.03.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm “Njoftim anëtarëve të Komisionit Disiplinor të ngritur me urdhrin nr. 89 prot., datë 26.03.2019”, janë njoftuar anëtarët e Komisionit Disiplinor për datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohej mbledhja, duke bërë të ditur detyrimin e anëtarëve të komisionit për t’u shprehur brenda afatit dy ditor, lidhur me faktin nëse për rastin në fjalë, ndonjëri prej tyre kishte pengesa ligjore për të vepruar si anëtar i komisionit disiplinor.

Pas konfirmimit të përbërjes së Komisionit të Disiplinës, në dt. 01.04.2019 është caktuar dita për zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e çështjes.

Nga përmbajtja e procesverbalit të mbajtur rezulton se në seancë dëgjimore janë thirrur, përveç dy nëpunësve të përfshirë në mosmarrëveshje, edhe nëpunësit ***** dhe ***** , të cilët kishin qenë të pranishëm në momentin e zhvillimit të konfliktit ndërmjet kolegëve të tyre.

Komisioni i Disiplinës pasi ka dëgjuar sqarimet e nëpunësve të pretenduar për shkeljen disiplinore si dhe deklaratimet e bëra nga nëpunësit dëshmitarë, ka vlerësuar se shkelja e kryer nuk ishte cilësuar siç duhet dhe ka vendosur ndryshimin e klasifikimit nga “shkelje e rëndë” në shkelje “shumë e rëndë”, të parashikuar nga shkronja “a”, pika 1 dhe shkronja “c”, pika 2, e nenit 57, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Më tej, procedurat administrative për realizimin e ecurisë disiplinorekanë vijuar me njoftimin e nëpunësve të proceduar për ndryshimin e klasifikimit të shkeljes disiplinore dhe caktimin e një seance tjetër dëgjimi në datën 08.04.2019. (Shkresanr. 1314/1 prot., datë 2.4.2019, e Sekretarit të Përgjithshëm).

Në datën 8.4.2019, provohet se Komisioni i Disiplinës në dy seanca të veçanta, ka kryer shqyrtimin e rasteve të dy nëpunësve në fjalë dhe në përfundim, me vendimin nr.15 dt. 08.04.2019, për nëpunësin ***** ka dhënë masën disiplinore “Largim nga shërbimi civil” me arsyetimin se nuk ka përbushur detyrën funksionale dhe ka

shkelur etikën në shërbimin civil, ndërsa me vendimin nr. 14 dt. 08.04.2019, për nëpunësin ***** ka vendosur ndërprerjen e shqyrtimit të shkeljes disiplinore, me arsyetimin se në veprimet e tij, pavarësisht konfliktit të krijuar, procedura e prokurimit (*hartimi i procesverbaleve dhe raportit përmbledhës*) është përmbushur brenda afateve ligjore, duke mos u shoqëruar me pasoja për institucionin.

Për sa u parashtua më sipër, arrihet në përfundimin se Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Mediave Audiovizive, në kryerjen e veprimeve administrative për realizimin e kësaj ecurie disiplinore, ka respektuar të gjitha kërkesat e pikës 1, të nenit 41, dhe pikës 7, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore deri në marrjen e vendimeve përfundimtare, (*si e drejta e nëpunësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar, provat për kryerjen e saj, e drejta për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, etj.*).

Por, ndërsa nga pikpamja e respektimit të procedurës së ecurive disiplinore, si për atë të nëpunësit ***** ashtu dhe atë të nëpunësit Enkelejd Lame, është treguar kujdes për kryerjen e një procesi të rregullt administrativ, nga pikëpamja e përmbajtjes së tyre paraqiten probleme, sidomos nga krahasimi i konkluzioneve të tyre, ku evidentohet mosrespektimi i parimit të barazisë dhe mbajtjes së standardit të njëjtë, në trajtimin e dy rasteve.

Në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve që janë në thelbin e kësaj mosmarrëveshje, është konstatuar se, gjithçka ka ndodhur në kushtet e mëposhtme:

Nëpunësi ***** me urdhrin e prokurimit nr. 28/1, datë 28.1.2019, është caktuar anëtar/jurist i njësisë së prokurimit, për procedurën me objekt "*Blerje automjete I/I (SUV) Fuoristradë*" ndërsa ***** është emëruar kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në të njëjtën procedurë prokurimi.

Në datën 25.3.2019, në ambientet e punës, të dy nëpunësit e sipërpërmendur, kanë debatuar mes tyre, duke ngritur tonet e zërit e në fund situata ka degraduar në konfrontim fizik me njëri tjetrin.

Konstatohet se, debati ndërmjet punonjësve në fjalë, ka filluar për shkak të një paqartësi ligjore që ata kanë patur, lidhur me faktin se kujt ia ngarkonte ligji detyrën hartimit të procesverbalit të hapjes së ofertave, procesverbalit të vlerësimit të ofertave dhe raportit përmbledhës të procesit të shqyrtimit e vlerësimit të ofertave. Fillimisht nëpunësit kanë komunikuar me telefon, me sms dhe me email (*emaillet e datës 18.3.2019*), ku nëpunësi ***** ka insistuar se hartimi i këtyre dokumenteve është detyrë e KVO, ndërsa ***** i ka cituar pikën 5, të nenit 64, kreut VII, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, ku parashikohet se: "*Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet e pasqyrohet në procesverbal. Njëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit është gjithmonë përgjegjës*

për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave". Sekretari i Përgjithshëm me email, i ka orientuar punonjësit që në lidhje me hartimin e procesverbaleve, të vijojnë veprimet sikurse është vepruar edhe në rastet e mëparshme.

Më pas, nëpunësi ***** është paraqitur në Agjencinë e Prokurimit Publik, për të marrë një mendim më të specializuar, ku e kanë sqaruar se në rastet e prokurimeve elektronike nuk është e nevojshme mbajtja e procesverbalit për hapjen e ofertave, sepse raporti realizohet nga vetë sistemi. Pasi është kthyer nga Agjencia e Prokurimit Publik, ai është paraqitur në zyrën e eprorit direkt (në zyrën e Drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe Licensave), për ta informuar në lidhje me udhëzimet që kishte marrë për rastin konkret. Në këtë kohë ka ardhur nëpunësi ***** duke përsëritur kërkesën e mëparshme dhe të dy nëpunësit kanë vijuar mosmarrëveshjen duke debatuar me tone të larta të zërit, i cili më pas ka degraduar në konflikt fizik. Kjo sjellje jonormale në ambientet e institucionit është parë edhe nga nëpunësit ***** dhe ***** i cili (ky i fundit) ka ndërhyrë për t'i ndarë.

Në rrethanat e përshkruara si më sipër, konstatohet se debati e më pas zënka ndërmjet nëpunësve ka ardhur për shkak të mosnjohjesi duhet e për këtë arsye edhe të moszbatimit prej tyre, të rregullave të prokurimit publik të përcaktuara në ligjin për prokurimin publik dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Nëse do të ishin zbatuar rregullat e prokurimit publik si dhe udhëzimet e dhëna nga eprorët kjo ngjarje jonormale nuk do të kishte ndodhur. Në rastin që po trajtojmë nëpunësit ***** dhe ***** ishin caktuar në komisionin e nëpunësve përgjegjës për realizimin e një prokurimi me mjete elektronike. Në shkronjën "b", të pikës 6, të nenit 52, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, është parashikuar në mënyrë të shprehur se në rastin e prokurimeve me mjete elektronike, dokumentacioni i paraqitur nga ofertuesit regjistrohet automatikisht në sistem dhe raporti që realizohet nga vetë sistemi, bëhet pjesë e dosjes së prokurimit. Për këtë arsye hapja e ofertave nuk shënohet në procesverbal.

Pra, mosmarrëveshja lidhur me faktin se kush e kishte për detyrë sipas ligjit hartimin e procesverbalit të hapjes së ofertave, ka ndodhur për një arsye që në thelb nuk ekzistonte dhe ka ardhur kryesisht, për shkak të mosnjohjes si duhet të rregullave dhe legjislacionit të prokurimit publik, gjë që ngarkon me përgjegjësi si nëpunësin e nivelit ekzekutiv ***** , ashtu dhe nëpunësin e nivelit të mesëm drejtues *****.

Në një rast të tillë, ***** , si nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues (pa lënë mënjanë përgjegjësinë e specialistit), kajo vetëm përgjegjësi direkte si pjesëtar në mosmarrëveshje por si kuadër drejtues, ka edhe përgjegjësi indirekte, pasi përmban në vetvete, eksperiencën, pjekurinë dhe formimin social-kulturor e profesional të vetin, cilësi të cilat kërkohen për emërimin në një pozicion të tillë. Në këtë vështrim, nëpunësi ***** ngarkohet me përgjegjësi të veçantë për faktin pse e ka lejuar vehten dhe situatën të degradonte në nivel kaq të ulët, sa të kapeshin me duar me një nëpunës

valtës, pikërisht në kohën që ai, po sqaronte eproren e tij të drejtëpërdrejtë, e cila në bashkëpunim edhe me kolegun e saj *****, kishte detyrimin të zgjidhte situatën për mënyrën si do të veprimej më tej.

Në vendimet nr. 14 dhe 15, dt. 08.04.2019, të Komisionit të Disiplinës, nuk vërehet që të jetë bërë një analizë e tillë, ku të mbahej parasysh jo vetëm barazia e palëve para ngjarjes së ndodhur dhe ligjit, por dhe përgjegjësia e diferencuar sipas intensitetit të veprimit të secilit dhe detyrimeve për kryerjen e rregullt të detyrës, sipas nivelit të shkallës së hierarkisë.

Duke mos mbajtur parasysh në veprimtarinë e tij, të parimeve të barazisë, mosdiskriminimit dhe zbatimit të njëjtë për të gjithë, të ligjit, Komisioni i Disiplinës ka arritur në konkluzione të gabuara; konkretisht, me vendimin 14, dt. 08.04.2019, ai ka ndërprerë ecurinë disiplinore ndaj nëpunësit *****, duke arsyetuar se ai ka mbajtur qëndrim pendues për ngjarjen, ka pranuar se ajo ka ndodhur në kushtet e keqkuptimit dhe mosnjohjes së ligjit nga ***** dhe pasi është ndjerë i provokuar nga sjellja dhe fjalori i këtij të fundit; ndërsa me vendimin nr. 15, në të njëjtën ditë, Komisioni i Disiplinës ka marrë masën disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, ndaj nëpunësit *****, duke arsyetuar se, pavarësisht që procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave, në prokurimin elektronik nuk është i nevojshëm të mbahet, mosrespektimi i këtij detyrimi që shprehet në pikën 5, të nenit 64, të vendimit nr.914, dt. 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, përbën tentativë për moskryerjen e detyrës funksionale, në mënyrë të vazhdueshme, si “*Specialist i Sektorit të Çështjeve Juridike*”. (theksojmë këtu se termi “*tentativë*” është një koncept që nuk parashikohet si element i përgjegjësive disiplinore, në të drejtën administrative, por kërkohet patjetër ardhja e pasojës së rëndë). Duke vijuar arsyetimin komisioni shprehet: “*...mosnjohja dhe moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave, kanë krijuar më pas konflikte, situata dhe veprime të papranueshme për figurën e nëpunësit civil...*”.

Pra, për të njëjtën çështje, për të njëjtin problem në përmbajtje, pa bërë një hetim tëdiferencuar dhe një analizë objektive të rrethanave të saj, Komisioni i Disiplinës ka mbajtur dy qëndrime diametralisht të ndryshme, gjë e cila flet për një qëndrim subjektiv, në favor të njërit e disfavor të tjetrit dhe në shkelje të ligjit nga ana e komisionit disiplinor.

Konkretisht, vendimet e mësipërme, në pjesën përshkruese të tyre, kanë një prezantim të ngjarjes me fjalë të përgjithëshme, me një arsyetim të përciptë dhe të determinuar prej konkluzionit, i cilidukej i paracaktuar që më parë. Ndryshe arsyetohet për rastin kur bëhet fjalë për ndërprerjen e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit ***** dhe ndryshe arsyetohet për përgjegjësitë e nëpunësve civilë në kryerjen e detyrës, kur flitet për ndëshkimin disiplinor të nëpunësit *****, gjë që do të thotë se Komisioni i Disiplinës ka punuar me dy standarde, duke mos respektuar parimet e përshkallëzimit dhe individualizimit të masës disiplinore, parashikuar nga neni 60 i ligjit

nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar dhe duke mos i trajtuar në mënyrë të barabartë para ligjit të dy nëpunësit.

Kjo ka ardhur, për shkak se Komisioni i Disiplinës, gjatë kryerjes së hetimit administrativ nuk ka bërë përpjekjet e duhura për të sqaruar mekanizmin e ngjarjes dhe për të përcaktuar drejt përgjegjësitë individuale të nëpunësve në këtë rast. Nga pohimet e palëve në mosmarrëveshje dhe dëshmitë e të pranishmëve, dalin të dhëna se ngjarja ka ndodhur kur nëpunësi ***** ishte duke raportuar tek eprori i tij direkt se dokumentet e kërkuaraqë ishin bërë shkak për mosmarrëveshjen (*procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave*), ishin të panevojshme në një prokurim online, por nëpunësi ***** , pa pritur sqarimet e rastit, duke patur edhe epërsinë e një detyre më të lartë se nëpunësi tjetër, megjithëse ka kryer veprime aktive në drejtim të acarimit të situatës, është mënjeluar të shënohet në konkluzionet e vendimit të komisionit dhe në vijim të këtij qëndrimi është vendosur ndërprerja e shqyrtimit të masës disiplinore, kurse për nëpunësin ***** , megjithëse është sjellë në mënyrë pasive, është mbajtur qëndrim më i ashpër duke e ndëshkuar me masën disiplinore më të rëndë që parashikon legjislacioni i shërbimit civil, atë të largimit nga shërbimi civil.

Edhe në vendimin e ndërmjetëm të datës 01.04.2019, nëpërmjet të cilit me shprehje të përgjithshme, si “*situatë e papranueshme*”, “*mospërmbushje e detyrave funksionale... prej të dy punonjësve*”, pa parashtruar ndonjë rrethanë të re rënduese, që nuk njihej deri në atë moment nga Komisioni i Disiplinës, si dhe pa dhënë ndonjë argument konkret në lidhje me pasojat shumë të rënda të ardhura nga shkelja disiplinore (*përkundrazi, konstatohet se në kohën kur po zhvillohej kjo ecuri, procedura e prokurimit ishte mbyllur me sukses dhe brenda afatit*) është vendosur ndryshimi i kualifikimit të shkeljes disiplinore nga “*shkelje e rëndë*” parashikuar prej nenit 57, pika 1/b, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, në “*shkelje shumë e rëndë*” parashikuar nga pika 1/a, e nenit 57, të ligjit në fjalë, shihet qartë ky qëndrim subjektiv dhe i pabazuar në ligj.

Nga mënyra si është vepruar më pas nga Komisioni i Disiplinës arrihet në përfundimin se ndaj nëpunësit ***** , është mbajtur qëndrim favorizues, duke e pushuar shqyrtimin e shkeljes disiplinore dhe duke i dhënë mundësi atij që të largohet nga detyra me një kërkesë për dorëheqje (*shih, urdhrin nr. 113 dt. 15.04.2019, me anë të të cilit është miratuar dorëheqja*) institut i cili, përmban edhe mundësitë që ofron dispozita e nenit 64, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për të filluar punë në një pozicion tjetër të shërbimit civil, nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, ndërsa nëpunësi ***** është vënë në pozita maksimalisht rënduese dhe është ndëshkuar me masën “*largim nga shërbimi civil*”.

Në përfundim të analizës së mësipërme, vlerësojmë se Komisioni i Disiplinës e ka menaxhuar në mënyrë të padrejtë këtë ecuri disiplinore, qoftë në momentin kur ka rënduar në mënyrë jo bindëse pozitën e të proceduarve, në momentin kur ka ndryshuar kualifikimin e shkeljes disiplinore nga “*shkelje e rëndë*” parashikuar prej nenit 57, pika

1/b, i ligjit nr. 152/2013,3 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në “shkelje shumë e rëndë” parashikuar nga pika 1/a, e nenit 57, të ligjit në fjalë, ashtu dhe kur ka vënë në pozita të pabarabarta nëpunës civilët cilët kanë vepruar në situata të njëjta. Pra, zgjedhja diskrecionale që ka bërë Komisioni i Disiplinës në rastin e vendimit të marrë për nëpunësin *****, duke mbajtur qëndrim haptazi të kundërt në raport me qëndrimin ndaj nëpunësit *****, përbën njëshkelje të parimit të proporcionalitetit dhe shmangie të pajustificuar të të drejtës, në kundërshtim me parimin e barazisë dhe ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parashikuar nga pika “ç” e nenit 11, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i procedurave administrative i RSH”.

Shqyrtimi dhe rregullimi i gjendjes së ligjshmërisë të veprimtarisë së një organi administrativ siç është Komisioni i Disiplinës në këtë rast, përfshihet brenda detyrimit që ka Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, sipas pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për të mbikëqyrur zbatimin e njëjtë të ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, prandaj analiza dhe vlerësimi i këtij rasti përfshin si vendimin nr. 14 ashtu dhe vendimin dhenr. 15, dt. 08.04.2019 të Komisionit të Disiplinës.

Shkeljet e lejuara/kryera nga Komisioni i Disiplinës, të përshkruara në pjesën e mësipërme të këtij vendimi, përbëjnë aspekte të paligjshmërisë së veprimtarisë së tij të cilat kanë ndikuar negativisht në vendimmarrjen dhe për rrjedhojë edhe aktet e përmbylljes së kësaj ecurie disiplinore, janë nxjerrë në kushtet e ushtrimit të diskrecionit në mënyrë jo të ligjshme dhe në shkelje të parimit të barazisë (pika 2, e nenit 17, të ligjit 44/2015, KPA) dhe proporcionalitetit (pika 2/c, e nenit 12, të ligjit nr. 44/2015, KPA).

Kjo situatë, në kuptim të pikave “dh” dhe “e” të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” i bën vendimet e sipërpërmendura akte të paligjshme, të cilat në bazë të pikës 1, të nenit 114, të ligjit në fjalë, duhet të anulohen në mënyrë diskrecionare (pra, nga vetë organi që ka diskrecionin për të kryer ecurinë dhe marrë masën disiplinore).

Megjithatë, në kushtet aktuale, kur me urdhrin nr. 113 dt. 15.04.2019 të Sekretarit të Përgjithëm të AMA-s, është miratuar dorëheqja e kërkuar nga nëpunësi ***** (kërkesë e paraqitur menjëherë pas ndërprerjes së ecurisë disiplinore, në dt. 10.04.2019), duke e liruar nga shërbimi civil, duke mbajtur parasysh parimin e mosrëndimit të pozitës së nëpunësit në mirëbesim, për të cilin flitet në nenin 114, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, vendimi nr.14, dt.08.04.2019 i Komisionit të Disiplinës nuk është e nevojshme të cënohet për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, ndërsa vendimi nr.15, dt.08.04.2019, duhet të bëhet objekt i rishqyrtimit dhe ndryshimit diskrecionar, nga ana e Komisionit të Disiplinës, si në drejtim të rikualifikimit të shkeljes disiplinore objekt shqyrtimi, sipas rrethanave konkrete të ngjarjes dhe shkallës aktive të pjesëmarrjes së nëpunësit të proceduar *****, ashtu dhe përzgjedhjes së masës disiplinore sipas parimeve për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore, parashikuar nga neni 60, i ligjit nr. 152/2013, “Për

nëpunësin civil” të ndryshuar dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative, të cilat u cituan dhe komentuan më sipër.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive, të drejtojë procesin administrativ në përmbajtje të të cilit, Komisioni i Disiplinës, në bazë të pikës 1, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, të anulojë Vendimin nr.15, datë 08.04.2019, për dhënien e masës disiplinore, “*Largim nga shërbimi civil*”, të nëpunësit ***** dhe të rishqyrtojë çështjen duke bërë një rivlerësim të rrethanave të ngjarjes dhe veprimeve të kryera nga nëpunësi në fjalë.
2. Për zgjedhjen e një mase të përshtatëshme disiplinore për nëpunësin ***** , në përputhje me parimet e përshkallëzimit dhe individualizimit të masës disiplinore parashikuar nga neni 60 i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” të ndryshuar, dhe rrethanat e reja të krijuara pas ndërprerjes së ecurisë
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 10 ditë, nga marrja dijani për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Të njoftohet për këtë vendim Autoriteti i Mediave Audiovizive, Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve që Raportojnë dhe Informojnë Kuvendin e Shqipërisë dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha